



NDRYSHIMI FILLON



NGA TI

RËNDËSIA E DEMOKRACISË NË NJË SHTET

SOMEJA (13), SENAD (12), AMIR (12), LORAN (12), LORENA (12), ENESA (13), OLTA (13), RINESË (12)



Kontributi ynë në një shtet demokratik

Demokracia është qeverisje e popullit, sepse vet populli i merr vendimet më të rëndësishme për shtetin e tij. Forma e parë e demokracisë u paraqit në Athinë në vitin 507 para erës së re. Në atë kohë, kanë pasur të drejtë vote të pasurit dhe burrat, kurse tash të gjithë janë të barabartë dhe kanë të drejtën e votës dhe të shprehjes së mendimit të lirë.


Janë dy lloje të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Republika e Kosovës ka demokracinë përfaqësuese parlamentare, sepse vet populli i zgjedh përfaqësuesit të cilët do ti përfaqsojnë ata në Kuvend dhe pastaj Kuvendi e zgjedh Qeverinë.

Element kyç i demokracisë është barazia. Përveç barazisë, elemente të tjera të demokracisë janë edhe paqja, liria, toleranca, respekti, solidariteti, shprehja e mendimit, sinqeriteti etj.

Të gjithë ne jemi pjesë e demokracisë dhe mund ta bëjmë atë edhe më të fuqishme duke i zbatuar elementet e saj. Kontributi ynë, mund të fillojë që nga shtëpia jonë, pastaj shkolla e deri tek shteti ynë. Ne duhet të vetëdijësohemi se çdo kontribut i yni për të mirë mund të ketë ndikim pozitiv në vend. Nëse bashkëpunojmë me njëri tjetrin, jemi të durueshëm dhe tolerant do të arrijmë që të japim mendime të ndryshme se si mund të ndryshojmë vendin për të mirë.

Prandaj, ne si qytetarë duhet të jemi aktiv në proceset

zgjedhore që mban vendi ynë, sepse edhe zgjedhjet janë formë e demokracisë dhe përmes tyre ne marrim pjesë në një proces të rëndësishëm që do të ndikoj në të ardhmen tonë.



Elementet e demokracisë



Mendimet tona vlejné

TË DHËNAT PËR KUVENDIN

ERJON (13), AGNES (12), ANDINA (12), SARA (13), LIREN (12), ALTINA (12), KUSHTRIM (13)

Çfarë ndodh në Kuvendin e Republikës së Kosovës? Sa deputetë janë aty? Cilat janë detyrat e Kuvendit? Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund t'i gjeni në artikullin më poshtë

Kuvendi i Republikës së Kosovës kujdeset për popullin e vet. Kuvendi ka për detyrë të miratoj ligjet dhe populli duhet t'i respektoj ato.

Përveç që ka detyrë të miratoj ligjet, Kuvendi i Kosovës ka edhe detyra tjera si: zgjedh Presidentin e Kosovës dhe mund ta shkarkoj atë, zgjedh Kryetarin e Kuvendit, e zgjedh Qeverinë dhe mund ta shkarkoj atë, po ashtu e kontrollon Qeverinë.


Në Kuvend punojnë deputetët. Këta deputetë zgjedhen nga populli dhe ndryshe quhen përfaqësuesit e popullit. Gjithsej Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, ku në mesin e atyre deputetëve 100 janë qytetarë shumicë, kurse 20 janë vende të garantuara për komunitetet jo shumicë.




Gazetarët e artikullit për Kuvendin e Kosovës



Kushtrimi dhe Lireni duke biseduar për çështjen e arsimit në Kosovë



Detyrat e Kuvendit të Kosovës



Funksionet e Kuvendit

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË TONA

VALMIR (13), BLEONA S. (12), DODË (12), BLEONA M. (12), LEARTA (12), AJOLA (12), ORKIDEA (12)


Sot kemi qenë dëshmitarë të zbatimit të një demokracie të mirë, ku kemi pasur mundësi të flasim se si ne si qytetarë kemi të drejtat dhe përgjegjësitë tona

Çdo njeri i përket një vendi të caktuar. Pasi që i përket një vendi, atëherë atë e quajmë qytetarë i atij vendi. Ne si qytetarë të Republikës së Kosovës, kemi të drejta dhe përgjegjësi. Përbushja e këtyre të drejtave dhe përgjegjësi bënë që të jemi qytetarë të ndershëm. Organizatat në kohërat e sotme janë krijuar për ti njoftuar njerëzit se sa të rëndësishme janë përbushjet e të drejtave dhe përgjegjësi. Si një përgjegjësi kryesore e jona është mirëmbajtja e ambientit. Kjo përgjegjësi në shkollën tonë që është „Pjetër Bogdani“ kryhet mjaft mirë. Në shkollën tonë ne e bëjmë riciklimin e shisheve të plastikës. Rëndësi të madhe kemi edhe ne fëmijët. Ne kemi të drejtat dhe përgjegjësitë tona. Ne duam që mendimet e tona të dëgjohen edhe nga


prindërit. Si e drejtë e fëmijëve është arsimimi. Ne në shkollën „Pjetër Bogdani“, japim ide të ndryshme dhe të gjithë së bashku mundohemi t'i realizojmë idetë tona, duke përbushur përgjegjësitë tona. Jemi të lumtur se veprimet tona brenda ambientit shkollor janë të shkëlqyera .

Duhet respektuar të drejtat dhe kryer përgjegjësitë tona jo vetëm në shkollë si institucion por në çdo vend. Në çdo kohë çdo njeri duhet të respektojë të drejtat e tjetrit dhe t'i përbushë përgjegjësitë në mënyrë që të cilësohet qytetar i ndershëm.

Prandaj bëhu edhe ti një qytetar i ndershëm për vete dhe për vendin tënd. Kjo është demokracia, dhe ne jemi pjesë e saj.



Të drejtat dhe përgjegjësitë tona nga Valmiri dhe Dodë



T'i respektojmë të tjerët që të fitojmë respektin e tyre



Unë mendoj për të mirën e qytetarëve



Ne punojmë për të mirën e vendit tonë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë